

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni mbi kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyer nga një agjenci përkthimi.

Rreth Bashkisë së Rrethit

Bashkia e Rrethit Kronoberg drejtohet nga Asambleja e Bashkisë së Rrethit e cila përbëhet nga politikanë të zgjedhur.

Asambleja e Bashkisë së Rrethit përbëhet nga 45 anëtarë të zgjedhur dhe është organi më i lartë vendimmarrës në Bashkinë e Rrethit. Ata vendosin për veprimet e Bashkisë së Rrethit bazuar në situatën aktuale të shëndetit në rreth, kërkesave për shëndetësinë, pajisjet mjekësore si dhe kuadrin financiar. Mbledhjet janë të hapura për publikun. Çdo mbledhje i mundëson qytetarët të bëjnë pyetjet në lidhje me aktivitetet e Bashkisë së Rrethit.

Bordi i Bashkisë së Rrethit i cili përbëhet nga 15 politikanë të zgjedhur udhëheq dhe koordinon punën e përgjithshme të aktiviteteve të bashkisë.

Sugjerimet e qytetarëve

Të gjithë qytetarët e Rrethit Kronoberg janë të mirëpritur të paraqesin sugjerime në lidhje me ndryshmet dhe përmirësimet e aktiviteteve të bashkisë. Ju duhet të shkruani emrin dhe përfshini adresën dhe numrin tuaj të telefonit. Shkruajini këto të dhëna të letër ose përdorni formularin që gjendet në faqen: www.ltkronoberg.se në pjesën “Internettjänster” (Shërbimet e internetit). Dërgojini në adresën:

Medborgarförslag
Landstinget Kronoberg
351 88 Växjö

Dialogu me qytetarët

Bashkia e Rrethit Kronoberg synon të fillojë një dialog me qytetarët gjatë vitit 2010 në: Qytetarët që duan të marrin pjesë, mund ta bëjnë këtë sipas dëshirës. Një anketë në internet që përmban një numër pyetjesh brenda një fushe të caktuar të interesit do të dërgohet me email disa herë gjatë vitit. Përgjigjet e anketës do të përfshihen në një raport i cili do t'i dërgohet pjesëmarrësve, politikanëve, zyrtarëve dhe do të publikohet edhe në faqen e internetit.